



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	DPKI	Nr. Prot.	
Dap.		B: Prot.	06-1436/20
Dep.		Prot No	
Nr. i faq		Data	06-07-2020
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages			
Republika e Kosovës			



## Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 03.07.2020, nxjerrë këtë:

### V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI- 06-1118/20*, për zyrtaren e lartë znj. Venera Berisha - Muharremi, Drejtoreshë e Klinikës së Endokrinologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë znj. Venera Berisha - Muharremi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtarja e lartë znj. Venera Berisha - Muharremi, Drejtoreshë e Klinikës së Endokrinologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, njëkohësisht është edhe person i autorizuar në bizneset private: “Këshillimorja për Dieta Prodieta” Sh.P.K., “DietA-Pro” Sh.P.K., “Stevia Line WED” Sh.P.K dhe “Dieta” Sh.P.K.

Agjencia kundër Korrupsionit, me qëllim të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesit kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) informatat për bizneset në fjalë (shkresa zyrtare: DPKI-06-516/20). Nga informatat për bizneset të pranuar prej ARBK-së (shkresa zyrtare: DPKI-06-01/516/20), është konstatuar se zyrtarja e lartë znj. Venera Berisha - Muharremi, është person i autorizuar në bizneset e sipërsënuara.



Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-1279/20, e ka njoftuar zyrtaren e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtaren e lartë lidhur me faktet për rastin e saj, si dhe e ka udhëzuar për veprimet që zyrtarja e lartë duhet t'i ndërmarrë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.*

Zyrtarja e lartë znj. Venera Berisha - Muharremi, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit, por ka deklaruar se kur ka marrë pozitën e Drejtoreshës në Klinikën Endokrinologjisë, ka inicuar kërkesat për ndryshime në biznese, por deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Megjithatë, ajo ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmangë gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar informatën (DPKI-06-1426/20), me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznese.

Pas analizimit të informatave mbi bizneset, Agjencia kundër Korrupsionit konstatoi se zyrtarja e lartë znj. Venera Berisha - Muharremi, ka transferuar të drejtat e drejtimit të bizneseve private tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.1 lidhur me nenin 15 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtarja e lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollë  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

